

**Njoftim për përqendrim me të cilin AJFH Ltd., Qipro do të fitojë kontroll mbi
SHOQËRINË AKSIONARE PËR QUMËSHT INDUSTRIAL DHE PRODUKTE TË
QUMËSHTIT IMLEK, PADINSKA SKELA, Serbi**

(lënda nr. 08-173 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 26.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin AJFH Ltd., Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e një personi me seli në adresën Agapinoros 2 & Arch. Makario III, 2, IRIS TOWER, kati 4, Apartamenti/Zyra 403-405, 1076, Nikozia, Qipro, do të fitojë kontroll mbi SHOQËRINË AKSIONARE PËR QUMËSHT INDUSTRIAL DHE PRODUKTE TË QUMËSHTIT IMLEK, PADINSKA SKELA, shoqëri aksionare publike e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, me seli në adresën Industrijsko Naselje b.b, Beograd, Serbi.

-**AJFH Ltd.** është kompani holding investuese e cila kryesisht investon në kapital privat dhe në tregje publike. Portofoli i AJFH Ltd. përbëhet nga investime në të cilat ajo vepron ose si investitor i vetëm, ose si bashkë-investitor.

-**SHOQËRIA AKSIONARE PËR QUMËSHT INDUSTRIAL DHE PRODUKTE TË QUMËSHTIT IMLEK, PADINSKA SKELA** është kompani ushqimore serbe me seli në Beograd, e specializuar për qumësht dhe produkte qumështi. Imlek është kompani rajonale që vepron në territoret e Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë së Veriut.

Portofoli i produkteve të SHOQËRISË AKSIONARE PËR QUMËSHT INDUSTRIAL DHE PRODUKTE TË QUMËSHTIT IMLEK, PADINSKA SKELA përfshin mbi 80 produkte qumështi, duke përfshirë qumësht, jogurt, djathë, gjalpë dhe pije me bazë bimore. Brendet e rëndësishme janë Moja Kravica, Jogud, Flert dhe Balans+.

SHOQËRIA AKSIONARE PËR QUMËSHT INDUSTRIAL DHE PRODUKTE TË QUMËSHTIT IMLEK, PADINSKA SKELA është e pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes një shoqërie të varur - **Mlekara AD Bitola** me seli të regjistruar në rrugën Gjurčin Naumov Plakot nr. 1, 7000 Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe veprimtari të regjistruar - prodhimi i produkteve të qumështit. Shoqëria e varur maqedonase e Imlek siguron një gamë të gjerë prej mbi 80 produkteve të qumështit me cilësi të lartë, të zhvilluara përmes inovacioneve të vazhdueshme dhe investimeve në teknologji të avancuar.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me tregjet përkatëse të produkteve: (i) **tregu për blerjen e qumështit të papërpunuar (të lopës)**; (ii) **tregu për prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit**; dhe (iii) **tregu për shpërndarjen e qumështit dhe produkteve të qumështit** në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të

dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

28.11.2025

Shkup